

## RAPORTI I WORKSHOPIT FINAL

### KONSULTIM ME PERSONAT E PREKUR NGA PROJEKTI I NDERTIMIT TE UJESJELLESIT TE DURRESIT PER INFORMIMIN E PROCEDURAVE TE SHPRONESIMIT PUBLIK

Komuna Milot & Ishëm, Shqipëri

*25 - 28 Janar 2013*

*Përgatitur nga:*

**Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike**

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## Tabela e Përmbajtjes

<b>PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>3</b>
<b>SFONDI.....</b>	<b>4</b>
<i>OBJEKTIVAT E WORKSHOP-IT FINAL.....</i>	<i>5</i>
<i>GJETJET KRYESORE TE RAP.....</i>	<i>5</i>
<b>RAPORT MBI KRYERJEN E WORKSHOP-IT .....</b>	<b>7</b>
<i>METODOLOGJIA.....</i>	<i>7</i>
<i>INSTRUMENTET E PËRDORURA PËR NJOFTIMIN E WORKSHOP-IT.....</i>	<i>8</i>
<i>AXHENDA.....</i>	<i>8</i>
<i>PJESËMARRËSIT .....</i>	<i>9</i>
<i>REKOMANDIMET.....</i>	<i>10</i>
<b>LISTA E SHTOJCAVE .....</b>	<b>11</b>
1. PROGRAMI.....	11
2. LISTA TOTALE E PJESËMARRËSVE TE FTUAR NE WORKSHOP .....	12
3. UDHËZIM PËR PRONARET E IDENTIFIKUAR SI PERSONA TE NDIKUAR NGA PROJEKTI .....	14
4. POSTERI INFORMATIV MBI PROJEKTIN .....	15

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Për tu siguruar se interesat e personave të ndikuar nga projekti i ndërtimit të ujësjellësit të ri për qytetin e Durrësit, janë pasqyruar plotësisht në procesin e RAP dhe restaurimin e të ardhurave, QSHKE u konsultua me personat e ndikuar, përfaqësuesit e çdo grupi të ndikuar, grupet e interesit dhe departamentet e ndryshme të administratës lokale në zonën ku do të zbatohet projekti. Disa nga takimet janë zhvilluar duke vizituar familjet e pronarëve dhe duke i ftuar ata për të marrë pjesë në konsultimet publike në nivel bashkie dhe komune, gjithashtu në kontakte individuale me ta për të siguruar njoftimin dhe praninë e tyre në workshopin final konsultues. Konsultimi final u realizua në përfundim të detyrës së QSHKE për hartimin e RAP dhe RPF, me personat e ndikuar nga projekti (PNP) si dhe me anëtarët e tjerë të komunitetit, e drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, të cilët shprehën interes në këtë projekt. Konsultime të ngjashme rekomandohen të vazhdojnë të mbahet deri në fazën e mbylljes së këtij procesi.

Organizimi i Seminarit (Workshopit) Final me grupet e interesit, është aktiviteti ku u ftuan të marrin pjesë të gjithë palët e përfshira në zbatimin e RAP, siç janë përfaqësuesit e Komunave/Bashkive të prekura nga shpronësimi dhe pronaret private që do të përvetësohet tokës nga shpronësimi (PNP). Për arsye logjistike dhe të disponibilitetit të palëve të interesuara, u realizuan dy workshope konsultimi, përkatësisht në Komunën Milot dhe Komunën Ishëm. Nëpërmjet këtyre takimeve u sqaruan dhe u diskutua mbi procedurat e shpronësimit dhe implikimet e tij, si procesi i kompensimit të tyre dhe u informohen seriozisht pronaret e tokave të prekura mbi të drejtat e tyre për dëmshpërblim dhe ankimim, aty ku kërkohet.

Takimet u organizuan në data 25 dhe 28 Janar 2013 nga konsulenti QSHKE dhe nën kujdesin e NJZP. Të gjithë pronaret (28) e tokave të identifikuar për shpronësim u ftuan të marrin pjesë së bashku me përfaqësuesit e katër njësive të qeverisjes vendore (Bashkia Sukth, Komuna Milot, Komuna Fushë Kuqes, Komuna Ishëm) si edhe përfaqësuesit e Bashkisë së Durrësit. Me gjithë përpjekjet për sigurimin e pjesëmarrjes së personave të ndikimit nga projekti, përfshirë komunikimin e drejtpërdrejtë me ta dhe nëpërmjet NJQV, si edhe ofrimin e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, të mbuluara nga NJMP, jo të gjithë pronaret e ndikuar nga projekti morën pjesë në këto takime. (Lista e Pjesëmarrësve në Shtojcën e këtij Raporti). Gjithsesi, konsulenti mori masat që informacionet e shpërndara gjatë konsultimit, të shpërndahen apo publikohen edhe në version *hard copy* nga NJQV në vende publike (Udhëzimet për ndjekjen e procedurave të kompensimit të tokës, animimit, etj).

Konsulenti në workshopin përfundimtar me grupet e interesit ftoi gjithashtu të merrnin pjesë edhe personat e prekur nga projekti nga dizenjimi i mëparshëm i gjurmës së ujësjellësit (nga Bashkia Mamurras), për t'i informuar ata për arsyet që zonat e Mamurrasit e dizenuar për shpronësim, ndryshoi pas rishikimit të gjurmës së tubacionit për arsye teknike dhe u zhvendos në Komunën Milot. Meqenëse disa nga pronarët e tokës mund të kishin planifikuar një investim në këto zona pas njoftimit për shpronësim dhe kompensimin

## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

e tokës së tyre, ata potencialisht mund të paraqesin ankesa për mos zbatimin e projektit në territorin e tokës së tyre. Prandaj, konsultim final me pronarët e ndikuar dhe/ose anëtarët e familjeve të tyre u konsideruar si një masë zbutje për tu shpjeguar atyre se projekti nuk do të marrë as tokën e tyre dhe as do të kompensojë atë si ishte parashikuar fillimisht. Në vijim Raporti jep detaje të organizimit të Workshopit final dhe rekomandimeve të gjetjeve të tij kryesore, për tu konsideruar gjatë zbatimit të RAP.

### SFONDI

Si pjesë e skemës së financimit të Bankës Botërore për "*Projektin e Investimit në Sektorin e Ujit*", po financohet ndërtimin e një tubacioni të ri për furnizimin me ujë të qytetit të Durrësit. Tubacioni i ri do të vendoset prej burimit në komunën e Milotit (rrethi i Lezhës) deri në qytetin e Durrësit, një distancë prej rreth 65 km. Ai do të ofrojë furnizim me ujë me kapacitet të plote, në kohë 24h dhe cilësi sipas parametrave të pranuar vetëm për qytetin e Durrësit, duke synuar ofrimin e një shërbimi të përmirësuar dhe të qëndrueshëm për këtë zonë. Ndërsa, tubacioni ekzistues i ujësjellësit do të rialokohet për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë me kapacitetet të plotë për fshatrat dhe komunitetet e vendosura përgjatë ujësjellësit ekzistues. Gjithashtu, projekti do të mbështesë financiarisht investime për përmirësime në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Durrësit.

Si pjesë e zbatimit të këtij projekti, QSHKE u angazhuar në përgatitjen e dy raporteve të vlerësimit të situatës, të cilët janë: **1) Plan Veprimi për Rivendosjen (RAP)** që përfshin një Shtojcë të veçantë të **Kuadrit të Politikave për Rivendosjen (RPF)**; dhe **2) Raportin e Vlerësimit Social (VS)** në komunitetet rurale të ndikuara nga projekti. Qëllimet e këtij vlerësimi janë renditur si vijon:

- i. Se pari, ky vlerësim kontribuon, në përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit për Rivendosje (RAP) për Ujësjellësin e Ri si dhe planin për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve të lidhur me të, ashtu si dhe çdo ndikim të mundshëm të lokalizuar nga furnizimi me ujë i komunitetit nëpërmjet depozitave të ujit dhe infrastrukturës së tij.
- ii. Së dyti, ky raport paraqet një vlerësim social-ekonomik të komuniteteve që do të furnizohen me ujë nga tubacioni i ri dhe atyre që furnizohen aktualisht me ujë nga tubacioni ekzistues i cili do të rialokohet për ti ndihmuar ata në një menaxhim optimal dhe të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimeve të ujit.
- iii. Ndërsa, Kuadri i Politikave të Rivendosjes (RPF) ka për qëllim të përshkruajë të gjitha risqet e mundshme të ndikimeve nga të gjithë komponentët e projektit, për të cilët gjurmët e sakta dhe ndikimet e tyre nuk janë të njohura ose të konfirmuar plotësisht deri më tani, si dhe masat lehtësuese të mbrojtjes sociale që lidhen me zbatimin e tyre.
- iv. Janë identifikuar komunitetet që preken nga përvetësimi i tokës për zbatimin e projektit, të cilat janë vendosur në njësitë administrative në vijim: Komuna e Fushë Kuqes, Komuna Ishëm, Komuna Milot dhe Bashkia Sukth.

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## Objektivat e Workshop-it Final

Workshopi mbuloi çështjet kryesore që prekin pronaret private të tokave që preken nga shpronësimi publik për ndërtimin e ujësjellësit të ri për qytetin e Durrësit, për informimin e tyre në lidhje me procedurën e shpronësimit, ligjin e shpronësimit në tërësi, qartësimin e kësaj procedure për personat e prekur nga shpronësimi publik dhe instrumentet e komunikimit me palët e interesuara dhe shpjegime të tjera të domosdoshme për lehtësimin e procedurave të shpronësimit dhe rrugët që ndiqen në rast të pakënaqësive ose ankesave me një nga hapat që parashikohen në këtë ligj.

### Objektivat kryesore të këtij workshopi:

- Komunikim me të gjithë personat e prekur nga ndërtimi i ujësjellësit të ri Fushe Milot - Durrës.
- Shpjegimi dhe ofrimi i një ndihme këshillimore mbi procedurat e shpronësimit dhe kuadrin ligjor në tërësi që rregullon këtë proces që nga hapi i parë deri në hapin e fundit.
- Ndërgjegjësimi i personave të afektuar nga ky investim publik mbi procedurat ligjore që ato duhet të ndjekin në rastet e mospajtueshmërisë së tyre me çmimin dhe sipërfaqen që do të shpronësohet.

Pjesëmarrësve iu shpërnda një "Udhëzues" i thjeshtë mbi të drejtat e tyre në lidhje me sa parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## Gjetjet Kryesore të RAP

Për të minimizuar efektet e zhvendosjes nga vendosja e tubacionit të ri të ujit, u siguria nga ana e projektit, që të shmangen sa më shumë të jetë e mundur tokat private të populluara me dendësi të lartë që preken nga zbatimi i projektit. Kjo u confirmua edhe nëpërmjet vëzhgimit në terren në kuadër të përgatitjes së RAP, i cili tregon se tubacioni i planifikuar i ujit në shumicën e gjatësisë së tij kalon përgjatë rrugës ekzistuese (në të djathtë të rrugës) dhe rrugëve që lidhin fshatrat, si dhe në kullota dhe lugina që janë pronë e subjekteve publike, të tilla si toka komunale. *Sipërfaqja e pashmangshme e tokës private, që preket për ndërtimin e tubacionit të ri të ujit rezulton 3487m<sup>2</sup> dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë 28 pronarë privatë me një total prej 34 parcelash tokë bujqësore.*

RAP konfirmoi se palët e vetme të ndikuara nga përvetësimi i tokës, për ndërtimin e ujësjellësit të ri, janë *pronarët privatë të tokës*. Janë identifikuar në total 28 pronarë për tu shpronësuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Blerja e tokës ndikon 34 parcela në katër njësi administrative, gjithsej 3487m<sup>2</sup>:

i. Komuna Milot	6 pronarë toke
ii. Komuna Fushë Kuqe	3 pronarë toke
iii. Bashkia Ishëm	18 pronarë toke
iv. Bashkia Sukth	1 pronar toke

## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

Toka e nevojshme për tubacionin e ri të ujit është e regjistruar si "*tokë bujqësore*" në katër njësi administrative. Vëzhgimet në terren dhe të dhënat e mbledhura përmes RAP tregojnë se, të gjithë pronarët e tokës e përdorin tokën si kullotë dhe për kultivimin e produkteve bujqësore. *Nuk ka banesa ose ndonjë strukturë tjetër, ose pemë në parcelat e identifikuar për shpronësim.*

Mënyra e kompensimit që vlen për këtë procedurë shpronësimi, si dhe për legjislacionin shqiptar në fuqi, është *kompensimi në të holla*. Mundësia e kompensimit "tokë-me-tokë" nuk ofrohet nga legjislacioni shqiptar<sup>1</sup> për pronarët privatë. Gjithsesi, vlerësohet se kompensimi në të holla është plotësisht i mjaftueshëm për të kompensuar tokën bujqësore të përvetësuar. Të gjithë personat e ndikuar nga projekti (PNP) kanë pranuar mënyrën e kompensimit në të holla për shpronësimin e tokës së tyre.

*Kostoja totale e përlogaritur për kompensimin e tokës së shpronësuar është 4,246,330.00 Lekë (afërsisht US\$ 44,462<sup>2</sup>) e vlefshme për një sipërfaqe totale të tokës prej 3487m<sup>2</sup>. RAP aplikon një çmim mesatar për shpronësimin e tokës për secilin prej zonave, si vijon: Komuna Fushë Kuqe (përfshirë Bashkinë Sukth) në 8 \$/m<sup>2</sup>, Komuna Milot në 10 \$/m<sup>2</sup>, Komuna Ishëm (fshati Lalëz) në 15 \$/m<sup>2</sup>.*

---

<sup>1</sup> Rasti i vetëm kur aplikohet kompensimi 'tokë me tokë' është atëherë kur njësi ekonomike e prekur është vetë Komuna dhe ajo që shpronësohet është një pronë komunale. Në këtë rast. Këshilli i Ministrave i jep një pronë tjetër komunës së prekur për kompensim. Megjithatë, edhe kjo është një praktikë e cila nuk është zbatuar deri tani nga Qeveria Shqiptare. Në çdo rast tjetër, sipas parimit themelor, për shpronësimin e një toke private është dhënë një kompensim i drejtë (parimi kushtetues) në të holla dhe jo në tokë.

<sup>2</sup> Kursi Këmbimit 1USD = 105 Lekë, Burimi: Banka e Shqipërisë (Mesatare e muajit Dhjetor): [http://www.bankofalbania.org/web/Kursi\\_i\\_Kembimit\\_2014\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/Kursi_i_Kembimit_2014_1.php)

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## RAPORT MBI DISKUTIMET NE WORKSHOP

Gjate workshopit, pjesëmarrësve iu shpërnda një udhëzues formal mbi hapat ligjore të parashikuar në rastet e ankimeve të mundshme nga ana e personave të prekur (që do të shpronësohen). Të gjithë pjesëmarrësve iu shpjeguan mënyra e funksionit dhe procedura administrative e ankimit të mundshëm. Pronareve iu dhënë shpjegime të përgjithshme mbi projektin që do të ndërtohet, si dhe sipërfaqen e tokës së tyre që do të zihet nga ndërtimi i puseve të marrjes së ujit, konkretisht nga 200 m<sup>2</sup> për secilin dhe çmimi i parashikuar sipas RAP prej 1000 ALL/m<sup>2</sup>. Po ashtu pronareve dhe përfaqësuesve të komunave iu shpërndanë kopje të udhëzimit/dokumentit sqarues të hapave ligjore, si dhe iu shpjeguan procedurat e nevojshme varësisht problemeve që mund të hasnin gjatë procedurës së shpronësimit.

**Pronaret e Komunës Milot u shprehen dakord me shpronësimin dhe çmimin e referuar, por nënvizuan:**

- kërkesën për punësim, si roje të pusit, në çastin e fillimit nga puna të këtij projekti,
- pasjen parasysh të një investimi për furnizimin me ujë të pijshëm të zonës së tyre (Fshati Fushe Milot).

Disa prej tyre ishin të gatshëm, të nënshkruanin menjëherë me institucionin shtetëror përgjegjës kontratën e kalimit të pronësisë së tokës që shpronësohet (Fushe – Milot), kundrejt shumës së kompensimit, pa pasur nevojë për vijimin e procedurës me VKM.

Pavarësisht faktit që nuk kishte ankesa ndaj vlerës së kompensimit apo procedurave të shpronësimit, të gjithë personat e prekur nga projekti në Komunën e Ishmit që ishin të pranishëm në workshop, duke deklaruar se përfaqësojnë edhe interesat e atyre që mungonin, identifikuan nevojën për ndryshimin e gjurmës së kalimit të tubacionit në tokat e tyre në komunën e Ishmit, duke sugjeruar që gjurma të devijohet nga pozicioni aktual në tokat e pronave të Ishmit për arsyen e vetme të përdorimit të pronës në të ardhmen prej tyre për ndërtim.

## Metodologjia

Metoda e përdorur për realizimin e workshopit është ajo e takimit të drejtpërdrejtë me pronaret dhe e sqarimit të tyre për disa aspekte:

- në lidhje me projektin që do të realizohet;
- mbi interesin publik të atij projekti;
- për minimizimin e cenimit të tyre gjatë realizimit të projektit;
- për të drejtat e tyre si pronarë jo vetëm për t'u kompensuar me një shpërblim të drejtë, por dhe për t'u ankuar deri në gjykatë, kur nuk janë dakord me sipërfaqen e shpronësuar, çmimin apo për çdo cenim eventual që mund t'u vije;
- dhënien secilit të një dokumenti me shkrim, 'Udhëzim', si një udhërrëfyes i thjeshtë në rast se del emri i tyre për shpronësim.

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## Instrumentet e përdorura për Njoftimin e Workshop-it

### a) **Njoftim nëpërmjet Afishimeve Publike**

Afishimi i njoftimit të aktivitetit “Konsultim me Publikun/Workshop” në periudhën e ndërgjegjësimit publik siç është raportuar edhe në RAP, në vende publike siç janë qendrat e Komunave, ku u afishuan edhe posteritë “Informacion i Përgjithshëm mbi Projektin”.

### b) **Njoftim në komunitet nëpërmjet Njërive të Qeverisjes Vendore (NJQV)**

Në funksion të identifikimit dhe të njoftimit të personave të ndikuar nga zbatimi i projektit, u bashkëpunua me pushtetin vendor, drejtuesit e NJQV. Theksojmë se në ZRPP disponohet informacion vetëm mbi emrin e pronarit, por nuk ka informacion mbi kontaktet dhe adresat e sakte të tyre. Në përfundim të këtij verifikimi, një numër PNP-ve iu identifikuan kontaktet e tyre nëpërmjet kontakteve me specialistet e NJQV (shih listën bashkëngjitur) Në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe NJZP në MPPT u informuan individualisht edhe pronarët e identifikuar në Bashkinë e Mamurrasit (mbi ndryshimin në projekt të gjurmës ku do të kalojë tubacioni i ujit). Nga konsultimi me ta nuk rezultoi të ketë ndonjë impakt në procesin e shpronësimit të lajmëruar me herët.

### c) **Komunikim telefonik me PNP**

Duke qenë se një numër PNP jetonin jashtë territorit të komunave në të cilën zotëronin pronën që afektohet nga zbatimi i projektit (kryesisht Durrës dhe Tiranë), përmes numërorit telefonik të qyteteve përkatëse (Botim i Albtelekom) u bë e mundur sigurimi i kontakteve telefonike me disa prej tyre dhe përcjellja e ftesës për të marrë pjesë në një workshop final të organizuar në Komunën Ishëm.

## Axhenda e Workshopit

Realizimi i workshopit u bë e mundur nga QSHKE me mbështetjen e Njesise së Zbatimit të Projekteve pranë MPPT. Workshopi u moderuar nga Eksperte të Çështjeve Ligjore për Pronat, dhe, Ekspert i RAP. Dy ekspertet e QSHKE kanë realizuar të gjitha aktivitetet e terrenit dhe vëzhgimet përkatëse në finalizimin e dy dokumenteve RAP dhe RPF.

Axhenda e hartuar nga ekspertet e RAP (QSHKE) përmbledhë:

- Informacionin mbi Projektin
- Gjetjet Kryesore të RAP (sipërfaqet dhe çmimi i kompensimit)
- Parimet e Shpronësimit
- Shpronësi si procedurë ligjore
- Procedurat e Ankimimit
- Procedurat e Kompensimit

Workshopi i Komunës Milot 25 Janar 2013

Workshopi i Komunës Ishëm 28 Janar 2013



## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

### Pjesëmarrësit e Workshopit

Në workshopin e mbajtur në Komunën Milot u ftuan të merrnin pjesë të 6 pronarët e identifikuar për shpronësimin publik, nga të cilët morën pjesë 5 të afektuar nga kryerja e këtij investimi. Ata ishin njoftuar publikisht, por edhe me mbështetjen e përfaqësuesve të njësive vendore, të cilët morën pjesë gjithashtu në workshop, duke përfshirë edhe Kryetarin e Komunës zt. Behar Haxhiu dhe Përgjegjësin e Zyrës Kadastrale në Komunë zt. Beqir Ahmeti.

Në workshopin e mbajtur në Komunën e Ishmit, u kërkua të merrnin pjesë pronarët e zonave të tjera (Sukth, Fushë Kuqe, Mamurras e Ishëm, gjithsej 22 pronarë). Njoftimet u bënë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me PNP dhe afishimeve pranë të programit pranë qendrave të NJQV. Pavarësisht, në këtë event morën pjesë vetëm 7 pronarë (të gjithë pronarë të regjistruar të komunës Ishëm). Në këto rrethana, grupi i punës hasi vështirësi në kontaktimin e pjesës së mbetur (as nga ZRPP qendrore as nga NJQV nuk gjendeshin kontakte apo/dhe adresa). Në këtë mënyrë është përdoruar metoda e gjetjes së kontakteve të tyre nga burime alternative, me anë të telefonatave të publikuar nga botimi i Albtelekom. Si rezultat i kësaj metode u kontaktuan 10 prej pronarëve të Komunës Ishëm nga 18 të identifikuar. Sipas vete pjesëmarrësve në workshop një pjesë e pronarëve është e pamundur të kontaktohen pasi janë jashtë shtetit (emigrante) ose të zhvendosur në Bashline Tirane e Durrës (migruar), pra nuk banojnë në zonat ku do të zbatohet RAP për shpronësimin publik.

Nr	Emri Mbiemri	Tel	Komuna
1	Loro Kola	682302657	Milot (Fushe Milot)
2	Frrok Kol Marku	682379468	Milot (Fushe Milot)
3	Sherif Veseli		Milot (Fushe Milot)
4	Dervish Zenel Haxhiu	682052553	Milot (Fushe Milot)
5	Murat Veseli	685851222	Milot (Fushe Milot)
6	Ndue Lazri	685776328	Milot (Fushe Milot)
7	Petrit Ruka	692129810	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
8	Besnik Bregu	683042593	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
9	Shpresa Sofija	694418189	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
10	Luan Saraci	682036913	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
11	Mahmut Balla	686014887	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
12	Refik Cela	692081356	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
13	Ndue Jaku	682090129	Ishëm (Gjiri i Lalzit)

Nr	Emri Mbiemri	Tel	Komuna
1	Behar Haxhiu	Kryetar I Komunës	Milot (Fushe Milot)
2	Beqir Ahmeti	Shefi Zyrës Kadastrale	Milot (Fushe Milot)
3	Klodian Dauti	Nënkryetar I Komunës	Ishëm
4	Mehmet Felaj	Shefi i Urbanistikes	Ishëm

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## Konkluzione dhe Rekomandime

- Ne workshopin e organizuar ne *Komunën Milot* personat e afektuar ishin te gjithë dakord, si me çmimin e shpronësimit ashtu dhe me sipërfaqen e përvetësuar te tokës, por ngritën një shqetësim ne lidhje me mundësinë e punësimit te një prej personave te familjes te cilit i shpronësohet toka nga ndërmarrje e ujësjellësit te Durrësit.
- Nga pjesëmarrësit si përfaqësues te komunës, Kryetari i Komunës dhe shefi i Zyrës Kadastrale kërkoi qe te shikohet mundësia e furnizimit me uje te banoreve te zonës përreth gjurmës ku do te vendoset tubacioni i ri i ujit.
- Ne workshopin e organizuar ne *Komunën Ishëm*, ku gjendet edhe numri me i madh i personave te afektuar nga ndërtimi i këtij ujësjellësi u ngrit shqetësimi për përdorimin e pronës se tyre ne një te ardhme te afërm. Duke qene se parcelat e tyre janë ne një forme te rregullt gjeometrike dhe ne krahun e majte te tyre shtrihet një kanal kullues, ata sugjeruan qe te shihet mundësia e zhvendosjes se linjës se tubacionit sa me afër kanalit qe te jete e mundur<sup>3</sup>.

---

<sup>3</sup> Nga komunikimi telefonik me personat qe kane marre pjese ne vendosjen/identifikimin e gjurmës se linjës se ujësjellësit (Ing. Sokol Allaraj nga COWI) per mundësinë e zhvendosjes se kësaj gjurme te linjës sa me afër kanalit u pohua se teknikisht është e pranueshme dhe se nuk përben ndonjë problem qe nuk mund te zgjidhet.

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## Lista e Shtojcave

### 1. Programi

**Data:** E Premte, 25 Janar 2013,  
**Vendi:** Komuna Milot, Salla e Mbledhjeve

10:30	Regjistrimi i Pjesëmarrësve
10.30 - 12.00	Prezantim i përgjithshëm i projektit Hapat kryesore ligjore ne procesin e shpronësimeve publike sipas RAP Pyetje dhe Përgjigje nga Pronaret
12:00	Kafe
12:30 – 14.00	Vizite ne Terren

---

**Data:** E Hëne, 28 Janar 2013,  
**Vendi:** Komuna Ishëm, Salla e Mbledhjeve

10:30	Regjistrimi i Pjesëmarrësve
10.30 - 12.00	Prezantim i përgjithshëm i projektit Hapat kryesore ligjore ne procesin e shpronësimeve publike sipas RAP Pyetje dhe Përgjigje nga Pronaret
12:00	Kafe
12:30 – 14.00	Vizite ne Terren

## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

### 2. Lista Totale e Pjesëmarrësve te Ftuar ne Workshop

Nr	Emri Mbiemri	Tel	Komuna
1	Loro Kola	682302657	Milot (Fushe Milot)
2	Frrok Kol Marku	682379468	Milot (Fushe Milot)
3	Sherif Veseli		Milot (Fushe Milot)
4	Dervish Zenel Haxhiu	682052553	Milot (Fushe Milot)
5	Murat Veseli	685851222	Milot (Fushe Milot)
6	Ndue Lazri	685776328	Milot (Fushe Milot)
7	Behar Haxhiu	Kryetar I Komunës	Milot (Fushe Milot)
8	Beqir Ahmeti	Shefi Zyrës Kadastrale	Milot (Fushe Milot)
9	Petrit Ruka	692129810	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
10	Besnik Bregu	683042593	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
11	Shpresa Sofija	694418189	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
12	Luan Saraci	682036913	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
13	Mahmut Balla	686014887	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
14	Refik Cela	692081356	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
15	Ndue Jaku	682090129	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
16	Klodian Dauti	Nënkryetar I Komunës	Ishëm (Gjiri i Lalzit)
17	Mehmet Felaj	Shefi i Urbanistikes	Ishëm (Gjiri i Lalzit)

### Foto nga Workshopi në Komunën Ishëm, 28 Janar 2013



## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

Foto nga Wokrshopi ne Komunën Milot, 25 Janar 2013



## PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

### 3. Udhëzim për Pronaret e Identifikuar si Persona te Ndikuar nga Projekti

*(Në rast se do të shpronësoheni për pronën tuaj nga ndërtimi i ujësjellësit të Durrësit)*

#### **1/ Dokumentet që ju nevojiten:**

- Vërtetimi i pronësisë (varësisht për tokë bujqësore, truall apo ndërtesë)

#### **2/ Njoftimi Zyrtar**

- Komisioni i Shpronësimit i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nxjerr njoftim në gazetë, po ashtu do t'iu njoftojë drejtpërdrejtë për shpronësimin.

#### **3/ Kompensimi**

- Nëse çmimi i njoftuar për shpronësim ju duket i arsyeshëm, ju e njoftoni Komisionin e Shpronësimit për këtë dhe lidhni kontratën përkatëse të kalimit të pronës. Komisioni i Shpronësimit ju paguan sipas çmimit të njoftuar.

#### **4/ Ankimimi**

- Nëse nuk jeni dakord me sipërfaqen e vënë në njoftimin për shpronësim, apo për çmimin me të cilin do të kompensoheni, duhet brenda 15 ditëve nga njoftimi në gazetë apo i drejtpërdrejtë, të paraqisni ankim në Komisionin e Shpronësimit.
- Si prova mund të paraqisni, një akt shitje të kohëve të fundit, për të thënë që çmimi është më i lartë, apo një kontratë me të cilën iu keni blerë kohët e fundit një pronë të ngjashme, etj.)
- Kur Komisioni bindet në atë ç'ka pretendoni e merr parasysh, p.sh që ju po iu merret një sipërfaqe toke më e madhe se ajo e njoftuar apo që iu takon një çmim më i lartë për tokën apo për kulturën bujqësore që po kultivoni, etj.

#### **5/Procedura**

- Nëse ju nuk bini dakord për t'u shpronësuar me ato kushte të njoftuara, atëherë vazhdon procedura: miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe ju mund ta kundërshtoni në Gjykatë nëse nuk jeni dakord, për sipërfaqen e pronës që ju kanë marrë dhe për çmimin e përcaktuar.

**6/ Në çdo rast mos hezitoni të kontaktoni në Ministrinë përkatëse (MPPTT) që ndjek shpronësimin.**

**7/ Po ashtu, nëse të drejtat tuaja nuk respektohen nga Komisioni i Shpronësimit apo MPPT, mos hezitoni të ankoheni te Avokati i Popullit, pasi e drejta e pronës është një e drejtë kushtetuese!**

# PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT

## 4. Posterit Informativ mbi Projektin

### Përshkrimi i Përgjithshëm i Projektit

Qeveria e Shqipërisë ka kërkuar mbështetjen e BERZH për zbatimin e **“Projektit për Investime në Sektorin e Ujit”**. Durrësi, duke qenë qyteti i dytë më i madh në Shqipëri, u përzgjedh si vendndodhje prioritare për financimin e investimeve thelbësore, sic është ai në sektorin e ujit. Për të lehtësuar hartimin dhe zbatimin efektiv, i gjithë projekti do të administrohet nga *Njësia e Zbatimit të Projekteve (PIU)*, e krijuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujërave dhe Shërbimeve Sanitare në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transporte.

Në kuadrin e këtij investimi, po ndërmerret: 1) *zbatimi i Planit të Veprimit për Rialokimin (RAP)* dhe 2) *vlerësimin e ndikimeve të mundshme social-ekonomike (Vlerësim Social)* në komunitet që krijon furnizimi me ujë nëpërmjet rezervuarëve ekzistues të ujit, si dhe infrastrukturës që do të përmirësohet për zbatimin e këtij investimi.

Qëllimi kryesor i projektit është që të ndërtojë një tubacion të ri të furnizimit me ujë nga pusi i vendosur në Fushë-Kuqe deri në qytetin e Durrësit, një distancë prej rreth 54 km. Tubacioni do të ofrojë një shërbim të përmirësuar të furnizimit me ujë të qyteti të Durrësit. Tubacioni ekzistues do të rialokohet për sigurimin e furnizimit me ujë të fshatrave dhe komunave të vendosura përgjatë vijës ekzistuese në të djathtë të rrugës. Projekti gjithashtu do të mbështesë përmirësimet në infrastrukture (rruge) dhe sistemin e ujërave të zeza të Durrësit. Objektivi specifik i Investimit është përmirësimi i cilësisë së ujit dhe furnizimi i rregull i tij, si dhe mbulimi i kostove për rajonin e Durrësit. Ky objektivi është bazuar në parimin që popullsia e prekur nga projekti do të ndihmohet duke përmirësuar standardet e tyre të jetesës.

**Projekti do të përbëhet nga tre komponentë kryesorë:**

#### ***I. Rrjeti kryesor i furnizimit me Ujë të Durrësit***

Ndërtimi i këtij segmenti të ujësjellësit është identifikuar si prioriteti kryesor për të zgjidhur problemin e mungesës së ujit me të cilin është përballur qyteti i Durrësit, sidomos gjatë periudhës së verës. Krahas ndërtimit të ujësjellësit, do të financohet gjithashtu ndërtimi i rrugëve si edhe rikonstruksioni i infrastrukturës lokale në pjesën ku kalon rrjeti i tubacioneve me qëllim që në të ardhmen të mund të bëhen ndërlidhje me rrjetin.

#### ***II. Investime ndihmëse për të lidhur zonën e Durrësit me rrjetin e furnizimit me ujë.***

Këto investime shtesë kanë të bëjnë me ndërtimin e rrjeteve ndërlidhëse për disa fshatra/komuna që mund të furnizohen me ujë në të ardhmen ose pajisjen e cdo zone shërbimi me rezervuar uji.

#### ***III. Programi për Menaxhimin e Kërkesës për Ujë***

Ky komponent, krahas investimeve të përmendura më sipër, do të mbështesë edhe agjendën e qeverisë për reforma më të gjera në nivel kombëtar, me ndërhyrje specifike sidomos në nivelin lokal, duke e marrë rajonin e Durrësit si një bazë për pilotim. Këto reforma do përfshijnë hartimin dhe zbatimin e Programit për Menaxhimin e Kërkesës për Ujë i cili përbëhet nga disa elemente. Së pari, programi do të përfshijë një strategji për vendosjen e matësve të ujit si në rrjetin kryesor ashtu edhe në pikën e lidhjes së çdo familjeje më rrjetin kryesor. Vendosja e matësve do të shoqërohet nga një marrëveshje për monitorimin dhe menaxhimin efektiv të matësve bazuar në modelin më të mirë institucional. Së dyti, do të ndërmerret një fushatë ndërgjegjësimi e fokusuar në domosdoshmërinë e

## **PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT NE SEKTORIN E UJIT**

mirë përdorimit të ujit dhe përmirësimin e menaxhimit të ujit, drejtuar jo vetëm banorëve por edhe institucioneve që e përdorin atë. Së treti, ky program do evidentojë lidhjen ndërmjet vendosjes së matëseve dhe përmirësimit të dhënave të mbledhura duke ofruar asistencë të vazhdueshme Njësisë së Monitorimit të Performancës dhe Krahasimit në MPPT. Së katërti, program do të ofrojë mbështetje dhe asistencë teknike për zgjedhjen dhe zbatimin e modelit të mundshëm institucional për rrjetin kryesor të furnizimit me ujë.